

## **DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**

**Qendra Mësimore**

**440 N. Broad Street**

**Philadelphia, Pennsylvania 19130**

Zyra e Kurrikulës, Mësimdhënies dhe Vlerësimit

Informacion për testin “Naglieri Nonverbal Assessment Test (NNAT)”

Komisioni i Reformës Shkollore ka miratuar blerjen e Testit “Naglieri Nonverbal Assessment Test” (NNAT), i cili do të aplikohet për të gjithë nxënësit e klasave të 2<sup>ta</sup>, në pranverë 2017. Ky dokument do t’ju ndihmojë të kuptoni se çfarë është NNAT dhe si mund të mbështetni edukimin e fëmijës nëpërmjet tij.

### **Çfarë është “Naglieri Nonverbal Assessment Test (NNAT)”?**

NNAT është një vlerësim jo verbal, që përdor informacionin pamor (vizual) të tillë si format e ndryshme dhe modelet, në vend të fjalëve, për vlerësimin e aftësive të veçanta të fëmijës. Në këtë test nuk ka asnjë kërkesë për lexim dhe të folur. Testimi jo verbal do të vlerësojë atësinë e fëmijës tuaj për analizën dhe zgjidhjen e problemeve komplekse, pa u kushtëzuar, ose kufizuar në aftësitë gjuhësore, ose të leximit.

### **Si do të përdoret informacioni?**

Informacioni nga NNAT do të përdoret nga mësuesit si një ndihmesë për realizimin e një profili më të plotë të aftësive të fëmijës tuaj; aftësi, të cilat mund të jenë të fshehura nga faktorë të tjerë, si psh gjuha. Kjo do t’i ndihmojë të gjithë edukatorët që të punojnë me fëmijën për identifikimin e e rrugëve më të mira për të mësuar. Një kopje e përfundimit të testit do t’ju dorëzohet edhe juve.

### **A përcakton ky test nëse fëmija im është i talentuar?**

Jo. Vetëm testi i NNAT nuk mund të përcaktojë nëse fëmija juaj është ose jo i talentuar. Nxënësit që marrin vlerësime të larta në testin e NNAT mundet të jenë, ose të mos jenë të talentuar. Ngjashmërisht, nxënësit me vlerësime të ulta në test, mundet gjithashtu të jenë të talentuar. NNAT e ka treguar, që të jetë një indikator i shkëlqyer për nxënësit me potenciale, apo që tregojnë talent. Kjo do të bëhet pjesë e të dhënave të profilit të fëmijës dhe do të ndikojë në rishikimin për talentin.

### **Çfarë përfshihet në test?**

Testi NNAT merret online dhe kërkon rreth 30 minuta. Të 38 artikujt janë të serieve të ndryshme të modeleve dhe formave. Fëmijët analizojnë këto modele dhe klikojnë në pjesën e munguar. Nxënësit do t’a kryejnë testin si një grup.

### **Si mund t’a ndihmoj fëmijën sa më mirë?**

NNAT nuk është një test tradicional. Kjo është si të zgjidhësh një pazëll ( puzzle). Nëse fëmija juaj nuk ka përvojë në format dhe modelet, lëreni të praktikohet dhe të mësojë se si t’i zgjidhë ato. Kjo është përgatitja më e mirë.

### **Cilin duhet të kontaktoj nëse kam ndonjë pyetje?**

Pyetjet mund të dërgohen në [gifted@philasd.org](mailto:gifted@philasd.org).